



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br.	48654/24
Nr. i fq. / Br. st.	-08-
Data: / Datum:	03.10.2024
VUSHTRRI - VUČITRN	



Datë: 03.10.2024

Nr. prot: \_\_\_\_\_

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

ORGANIZATËS GERMIN

DHE

KOMUNËS SË VUSHTRRISË



**Komuna e Vushtrrisë** dhe Organizata **GERMIN**, në vijim referuar si “Palët”.

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e këtij memorandumi kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me synim të angazhimit të Diasporës për avancimin e barazis gjinore.

Komuna e Vushtrrisë është një nga komunat e Kosovës, e njojur për zhvillimin e saj ekonomik dhe kulturor. Me një popullsi të larmishme dhe një histori të pasur, komuna e Vushtrrisë ka një rol të rëndësishëm në rajon, duke ofruar mundësi për arsim, biznes dhe aktivitete komunitare. Komuna ka punuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, duke synuar të krijojë një mjeshtëri qëndrueshëm dhe të favorshëm për jetën e qytetarëve të saj.

Germin është një organizatë joqeveritare që përdor teknologjinë dhe kanalet virtuale për të lidhur dhe angazhuar Diasporën në avancimin e zhvillimit dhe demokratizimit të vendeve amë. Germin filloi në 2011 si një grup joformal që përpinqej të gjente rrugën për t'u lidhur me atdheun dhe u themelua zyrtarisht në 2014. Germin drejtohet dhe mbështetet nga një grup profesionistësh të Diasporës duke filluar nga fusha e politikave publike, financave, informacionit, teknologjisë, ligjit, arsimit, sigurisë dhe diplomacisë. Germin ka një rrjet të gjerë profesionistësh dhe bashkëpunëtorësh me kohë të pjesshme, që aktualisht banojnë në 24 vende, përfshirë Ballkanin, Evropën Perëndimore dhe Amerikën e Veriut.

Palët angazhohen për të bashkëpunuar me njëra-tjetrën duke rënë dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi sipas kushteve të mëposhtme:

Ky memorandum lidhet për periudhat kohore **Tetor 2024 – Tetor 2025**.



## Neni 1

### Objektivi

Objektivi i përgjithshëm i këtij memorandumi është realizimi i shkëmbimeve dhe bashkërendimi i aktiviteteve që ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve të Komunës së Vushtrrisë në fusha të ndryshme përmes:

1. Angazhimit të Profesionistëve nga Diaspora në Komunë për të shkëmbyer dhe transferuar njohuritë dhe shkathësitë e tyre tek zyratrët komunal;
2. Organizimi i punëtorive (worshkops), trajnimeve dhe konferencave të përbashkëta me qëllim rritjen e kapaciteteve komunale për bashkëpunim me diasporën në fusha të ndryshme;
3. Avancimin e njohurive dhe kapaciteteve të zyrtarve komunal me fokus, por duke u mos mjaftuar, në tema si:
  - a. Barazia Gjinore;
  - b. Ngritja e fondevë;
  - c. Hartimi dhe zbatimi i projekteve;
  - d. Tërheqja e investimeve nga diaspora;
  - e. Rrjetëzimi me organizata dhe institucione ndërkombëtare:

## Neni 2

### Parimet e përgjithshme

1. Palët në këtë memorandum udhëhiqen nga parimi i barazisë dhe përfitimit të ndërsjellë.
2. Palët vlerësojnë interesin e përbashkët për të ruajtur dhe zhvilluar formën e bashkëpunimit për të promovuar, organizuar dhe realizuar aktivitetet referuar këtij memorandumi.
3. Palët detyrohen ndërsjelltas të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me informacionin, të dhënët që do të shkëmbejnë gjatë vlefshmërisë dhe/ose zbatimit të këtij memorandumi, me vendimmarrjen e përbashkët të tyre.

## Neni 3

### Detyrimet dhe obligimet e palëve

Për të arritur objektivat e përbashkëta të përshkruara në këtë memorandum, palët bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë, ndër të tjera, për të nxitur koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Zyres për Barazi Gjinore në Komunën e Vushtrrisë dhe organizatës GERMIN për të krijuar një mjesid të favorshëm për promovimin e Barazisë Gjinore. Bashkëpunimi në veçanti do të shtrihet në përmbrushjen e aktiviteteve të mëposhtme:



### Obligimet e GERMIN:

- Germin do të angazhoj një Profesioniste nga Diaspora në Zyren për Barazi Gjinore në Komunën e Vushtrrisë përmes projektit “Diaspora për Gratë në Politikë”;
- Profesionistja nga Diaspora do të qëndroj fizikisht një (1) javë ndërsa dy (2) javë të tjera angazhohet virtualisht në Zyren për Barazi Gjinore;
- Profesionistja nga Diaspora do të ndihmoj në rishikimin/përpilimin e dokumenteve strategjike të Zyres për Barazi Gjinore në Komunën e Vushtrrisë duke u munduar të sjell një përspektiv evropiane nga përvoja e saj;
- Profesionistja nga Diaspora në fund të angazhimit do të bëjë një përbledhje në dokument me punët dhe rezultatet e saj gjatë angazhimit;
- Germin edhe pas muajit tetor, do të përfshijë gratë asambleiste dhe zyrtaret brenda Komunës së Vushtrrisë në projektin “Diaspora për Gratë në Politikë”;
- Germin në bashkëpunim me Gratë Asambleiste dhe Zyren për Barazi Gjinore do të ndërmarrin një iniciativë gjatë vitit 2025 në të mirë të barazisë gjinore, ku Germin do mbështesë iniciativën me vlerë financiare prej 1000 euro.
- Promovimi i aktivitetave të njëra-tjetrës - Palët promovojnë aktivitetet e njëra-tjetrës tek audiencat e tyre përkatëse. Për shembull, nëse njëra palë është e fokusuar në promovimin e të drejtave të diasporës, pala tjetër mund të ndihmojë në promovimin e këtyre përpjekjeve tek ndjekësit e saj.

### Obligimet e Komunës së Vushtrrisë:

- Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Vushtrrisë do të sigurohet të krijoj një hapësirë pune brenda zyres ku vepron për profesionistin/en e diasporës;
- Zyrtarja për Barazi Gjinore do të ndajë të gjitha dokumentet e nevojshme me Profesionisten nga Diaspora në menyrë që të ndihmoj në rishikimin/përpilimin e dokumenteve strategjike të Zyres për Barazi Gjinore në Komunën e Vushtrrisë duke u munduar të sjell një përspektiv evropiane nga përvoja e saj;
- Zyrtarja për barazi Gjinore sigurohet që të përfshijë profesionistën në takime të cilat organizohen brenda dhe jashtë zyres që kanë të bëjnë me Barazi Gjinore gjatë periudhës së angazhimit;
- Komuna e Vushtrrisë nuk ka obligime financiare karshi profesionistës nga Diaspora. Shpenzimet mbulohen nga Germin.
- Komuna e Vushtrrisë sa i përket iniciativës mund të kontribuoj finansiarisht shtesë shumës së



paraparë nga Germin, varësisht prej nevojës dhe kostos që do të ketë iniciativa, por nuk është e obliguar.

- Promovimi i aktiviteteve me interes të përbashkët: Palët promovojnë aktivitetet e njëra-tjetrës tek audiencat e tyre përkatëse. Për shembull, nëse njëra palë është e fokusuar në promovimin e të drejtave të diasporës, pala tjetër mund të ndihmojë në promovimin e këtyre përpjekjeve tek ndjekësit e saj.

#### **Neni 4**

##### **Format e bashkëpunimit**

1. Palët janë pajtuar që ky memorandum nuk do të përjashtojë mundësinë e formave të tjera të bashkëpunimit me subjekte të tjera që nuk janë palë e këtij memorandumi, me kusht që bashkëpunimet me palët e treta të mos bien ndesh me qëllimin e këtij memorandumi.

#### **Neni 5**

##### **Komunikimi mes palëve**

1. Palët, angazhohen të mbajnë një komunikim të vazdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbujnë çdo informacion të nevojshëm për përbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike;
2. Palët angazhohen të janë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njëra-tjetrën me qëllim bashkërendimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.
3. Komunikimi nga Organizata Germin do të bëhet nga Menaxherja e projektit, Blerinë Ukshini
4. Komunikimi nga Komuna e Vushtrrisë do te bëhet nga Zyrtarja për Barazi Gjinore znj. Remzije Zekolli

#### **Neni 6**

##### **Mosmarrëveshjet**

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

#### **Neni 7**

##### **Monitorimi dhe vlerësimi**

Progresi i partneritetit, objekt i këtij Memorandumi, do të monitorohet dhe vlerësohet nga Palët. Kjo mund të përfshijë komunikim të rregullt ndërmjet palëve, raporte progresi mbi arritjet e qëllimeve dhe objektivave të dakorduara, ose metoda të tjera të vlerësimit të efektivitetit të bashkëpunimit. Monitorimi dhe vlerësimi janë thelbësore për të siguruar që partneriteti po arrin rezultatet e synuara, duke identifikuar fushat ku mund të bëhen përmirësime dhe duke përshtatur qasjen në përputhje me rrethanat. Duke vendosur një proces të strukturuar monitorimi dhe vlerësimi, palët mund të ruajnë



---

Ilogaridhënien dhe transparencën, të ndjekin përparimin e tyre dhe të identifikojnë mundësitë për të mësuar dhe përmirësuar.

#### **Neni 8**

##### **Të drejtat e pronësisë intelektuale**

Çdo pronë intelektuale e krijuar bashkërisht nga palët do të jetë në pronësi të përbashkët dhe secila palë do të ketë të drejtën ta përdorë këtë pronë intelektuale për qëllimet e veta jo komerciale. Nëse secila palë dëshiron të përdorë pronën intelektuale të përbashkët për qëllime komerciale, ajo duhet të kërkojë pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër dhe të bien dakord për një marrëveshje të pranueshme reciprokisht. Çdo pronë intelektuale para-ekzistuese në pronësi të secilës palë do të mbetet pronë e pronarit fillestare.

#### **Neni 9**

##### **Kohëzgjatja, procedura e rinvimit dhe e drejta e térheqjes**

1. Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët dhe është i vlefshëm deri më 31 tetor 2025.
2. Palët mund të bëjnë ndryshime eventuale apo të térhiqen nga ky memorandum, duke i komunikuar me shkrim palës tjetër. Térheqja e palëve nga ky memorandum nuk prodhon efekte mbi marrëdhëniet që kanë filluar të ekzistojnë gjatë kohës që ky memorandum ka qenë në fuqi.

#### **Neni 10**

##### **Gjuha e Memorandumit**

Ky Memorandum hartohet në gjuhën shqipe në 2 kopje për secilën palë.



## Neni 11

### Nënshkrimi

Ky memorandum hartohet në 2 kopje për secilën palë dhe nënshkruhet me datë 3 tetor 2024.

### PËR KOMUNËN E VUSHTRRISË:

Znj. Hyrije Uka Hoxha | Pozita: Drejtoreshë e Administratës, Komuna e Vushtrrisë

Nënshkrimi: H. Hoxha | Data: 3 tetor 2024



### PËR ORGANIZATËN GERMIN

Znj. Sihana Bejtullahu | Pozita: Bashkë-Drejtoreshë, Germin

Nënshkrimi: S. Bejtullahu | Data: 3 tetor 2024

